



AKTI I THEMELIMIT I SHOQERISE TREGTARE

"MRM "SHPK SHOQERI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR.

Sot ne date 2.052001 ne qytetin e Korces ne palet kontraktuese:

1. Renato KOCIBELLI.
2. Maksim SOTIRI.
3. Markelian KUQO.

rame dakort qe te zhvillojme veprimtari ekonomike private nepermjet bashkimit te pasurive tona personale ne formen e nje shoqerije tregtare te organizuar si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar dhe me emertimin "MRM "SHPK,ne mbeshtetje te ligjes Nr. 7638 date 19.11.1992 " Per shoqerite tregtare ".

NENI 1

Shoqerija me pergjegjesi te kufizuar e lartpermendur eshte person juridik me qender ne qytetin e Korces dhe me te drejte perfaqesimi ne forme filiali,pjesmarse ne nje shoqeri te dyte apo kontrolluese ne nje shoqeri tjeter ne gjithe teritorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj.

Kjo shoqeri ka per qellim qe veprimtarine e saj ta realizoje ne keto drejtime kryesore :

1. Veprimtari Radio-Televizive,prodhimi,transmetimi e ritransmetimi I programeve dhe informacioneve te cdo lloji me ane te zerit,figures,sinjaleve te koduara,shkrimit te destinuara per publikun nepermjet valeve elektromanjetike,kabllove,perseritesave,sateliteve apo me cdo mjet tjeter.
- 2.Prodhim I dokumentareve dhe filmave si dhe cdo gjini te medias audio-vizive.
- 3.Prodhimi,riprodhimi dhe tregetimi me shumicee pakice I programeve audio-vizive ne kaseta,kompakdisqeve dhe D.V.D-ve.
- 4.Prodhim tregetim transmetim menaxhimi reklamave apo mesazheve promocionale
- 5.Organizimi I aktiviteve artistike ,kulturore ,sportive ne shkalle lokale e kombetare.
- 6.Shitblerjen e te drejtave radiotelevizive tek te tretet dhe nga te tretet.
- 7.Import - eksport ,transport te te gjitha paisjeve ,lendeve te para ,si edhe cdo mjet tjeter ndihmes per mediat audiovizive.
- 8.Import - eksport ,transport, prodhim, riparim e montim per te tretet me matriale te veta ose te porositesit ne fushen audiovizive(Fason).

Objekti,veprimtarija e kesaj shoqerije me pergjegjesi te kufizuar,organizimi si dhe maredheniet e saj ne qarkullimin civil me shtetas shqiptare apo te huaj,me persona juridike,publike ,e private shqiptare apo te huaj parcaktohen ne statutin e shoqerise dhe regullohen nga legjislacioni ne fuqi I Republikes se Shqiperise.

NENI 2

Kapitali themeltar I shoqerise.

Kapitali themeltar I shoqerise tregtare "MRM"SHPK kap nje vlere prej 100

000 lek.

Konkretisht pjeset e paleve kontraktuese ne kapitalin themeltar te kesaj shoqerije perbehen nga :

1. Ortaku themelues Renato KOCIBELLI 40 %
2. Ortaku themelues Maksim SOTIRI 30 %
3. Ortaku themelues Markelian KUQO 30 %

Ne baze te kapitalit te vendosur ne kete shoqeri fitimi do te ndahet ne masen 40% per Renato Kocibelli ,30% per Maksim Sotiri dhe 30% per Markelian Kuqo .

NENI 3

Kapitali baze I shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "MRM" SHPK sipas Nenit 2 te ketij Akti perfaqeson kapitalin e nevojshem per themelimin e shoqerise tregtare.

Kapitali i nevojshem per veprimtarine ekonomike e tregtare te kesaj shoqerije do te trajtohet si kapital investues.

NENI 4

Shoqerija tregtare "MRM" SHPK fiton personalitet juridik pas regjistrimit te saj ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor, Tirane.

Shoqerija tregtare "MRM" SHPK gezon personalitet juridik shqiptar.

NENI 5

Afati I kohezgjatjes se veprimtarise se kesaj shoqerije nuk paracaktohet.

NENI 6

Ne mbeshtetje te ligjes "Per kontabilitetin" pasqyrohet fondi themeltar I paleve kontraktuese ku shenohen kapitalet e vena prej tyre ne baze te Nenit 2 te ketij Akti.

Fondet ne investime nenshkruhen ne raport me vleren e tyre dhe do ti pergjigjen fazes se aktivitetit sipas kesaj mareveshjeje te ortakeve themelues.



NENI 7

Kjo shoqeri me pergjegjesi te kufizuar pergjigjet per detyrimet e veta me fondet e saj.

NENI 8

Te drejtat e paleve kontraktuese jane :

1. te marrin pjese ne drejtimin e kesaj shoqerije.
2. te marrin pjese ne ndarjen e fitimit te shoqerise ne perputhje me statutin e saj.
3. te marrin pjesen perkatese ne pasurine e shoqerise me pushimin e aktivitetit te saj.
4. te pergjigjen per detyrimet e shoqerise ne kufijte e kapitalit te investuar ne kete shoqeri.





NENI 9

Detyrimet e paleve kontraktuese jane:

1. te shlyejne kapitalin themeltar te shoqerise per pjesen takuese sipas Nenit 2 te Aktit te themelimit.
2. te marrin pjese ne drejtimin e shoqerise sipas statutit.
3. te ruajne sekretet e shoqerise.
4. te veprojne me inisiative per realizimin e sukseshem te veprimtarise se kesaj shoqerije me pergjegjesi te kufizuar sipas percaktimeve te bera ne statut.
5. te marrin pjese ne te gjitha mbledhjet e asamblese se ortakeve.
6. kjo ortakeri perjashton cdo mundesi te konkurences se pandershme.

NENI 10

Palet kontraktuese kane rene dakort qe ndarja e fitimeve qe do te rezultojne nga aktiviteti I shoqerise tregtare "MRM" SHPK pas likujdimit te taksave dhe tatimeve e gjithë shpenzimeve te tjera do te ndahen nga ortaket themelues ne masen 40% per Renato Kocibelli ,30% per Maksim Sotiri dhe 30% per Markelian Kuqo .

NENI 11

Cmimet e blerjes dhe te shitjes te prodhimeve sipas objektit te kesaj shoqerie normalisht do te caktohen nga vete drejtuesit e shoqerise sipas kerkeses dhe ofertes ne treg.

Marka e prodhimeve sipas objektit te kasaj shoqerie percaktohet me marveshje te ortakve themelues.

Veprimtaria televizive e kesaj shoqerije tregtare do te mbaje emertimin "LOBI VIZION".

NENI 12

Palet kontraktuese kane rene dakort qe te gjithë personat qe do te punesohen prane kesaj shoqerije tregtare,punesimi I tyre do te behet mbi bazen e nje kontrate te vecante ne te cilen do te percaktohen te drejtat dhe detrimet ligjore te sejciles pale si dhe paga mujore ne mbeshtetje te legjislacionit shqiptar qe rregullon marredheniet e punes.

NENI 13


Organizimi dhe drejtimi I shoqerise tregtare do te behen sipas statutit te saj mbeshtetur ne dispozitat ligjore qe rregullojne shoqerite tregtare me pergjegjesi te kufizuar.

NENI 14

Te gjitha mosmareveshjet qe nuk do te zgjidhen me mirekuptim nga pala kontraktuese do te zgjidhen nga Gjykata e Rrrethit gjyqesor Korce.


NENI 15

Kjo kontrate perpilohet ne 6(gjashte) egzemplare origjinale.




PALET KONTRAKTUESE


Renato KOCIBELLI



Maksim SOTIRI



Markelian KUQO





REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE KORCE
NOTERI Vladimir MOLLA.
NR 2190 Rep.
NR 416 Kol.

VERTETIM NENSHKRIMI

Sot, me 2.05.2001, ditën e Merkurës, pra meje Noter VLADIMIR FEHMI MOLLA, anetar i Dhomes se Notereve Korce, qe kryej veperimtari si Noter ne zyren qe ndodhet ne Qytetin e Korces ne Rrugen "6 Deshmoret", u paraqiten qytetaret Renato KOCIBELLI, I BIRI I Beharit dhe I Krisanthit, me dt. lindje 1963, banues ne Korce, Maksim SOTIRI, I biri I Vangjelit dhe I Julia, me dt. lindje 1962, banues ne Korce dhe Markelian KUQO, I biri I Gezimit dhe I Zhanetes, me dt. lindje 1972, banues ne Korce, madhore, te afte per te kryer veprime juridike, te njohur prej meje Noterit, te cilet nenshkruan ketu para meje Aktin e Themelimit te Shoqerise tregtare "MRM" Shpk, me qender ne Korce, si ortake themelues te kesaj shoqerije dhe une Noteri sipas ligjit vertetoj nenshkrimin e tyre.

**NOTER
VLADIMIR FEHMI MOLLA**



STATUT
I
SHOQERISE TREGTARE



“MRM” SHPK
SHOQERI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

KREU I PARE
Pjesa e pergjithshme.

NENI 1

Shoqerija tregtare “MRM” SHPK formohet si shoqeri me tre ortakë:

- 1.z.Renato Kocibelli
- 2.z.Maksim Sotiri
- 3.z.Markelian Kuqo,

Te cilet nepermjet Aktit te themelimit kane rene dakort te destinojne ne nje sipermarrje pasurite e tyre me qellim qe te ndajne fitimin ose qe te mund te perfitojne nga te ardhurat qe rrjedhin prej saj.

Shoqerija tregtare do te mbaje emertimin “MRM” SHPK.

Veprimtaria televizive ne permbushje te objektit te kesaj shoqerie tregtare mban emertimin (siglen) “LOBI VIZION”.

Ne rast transferimi te veprimtarise tregtare mund te rruhet I njeiti emertim me kusht qe personi juridik te shtoje ne kete emertim nje shenim I cili ka te beje me transferimin.

NENI 2

Shoqerija tregtare “MRM” SHPK ka karakter tregtar dhe eshte e organizuar si shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar (SHPK).

Ortakët e kesaj shoqerije tregtare marrin persiper te paguajne pjeset qe u takojne nga humbjet e aktivitetit tregtar ne kete shoqeri.

NENI 3

Shoqerija tregtare “MRM” SHPK ka si objekt te veprimtarise se saj :

1. Veprimtari Radio-Televizive, prodhimi, transmetimi e ritransmetimi I programeve dhe informacioneve te cdo lloji me ane te zerit, figures, sinjaleve te koduara, shkrimi te destinuar per publikun nepermjet valeve elektromanjetike, kablllove, perseritesave, sateliteve apo me cdo mjet tjeter.
2. Prodhim I dokumentareve dhe filmave si dhe cdo gjini te medias audio-vizive.
3. Prodhimi, riprodhimi dhe tregtimi me shumicee pakice I programeve audio-vizive ne kaseta, kompakdisqeve dhe D. V. D-ve.
4. Prodhim tregtim transmetim menaxhimi reklamave apo mesazheve promocionale
5. Organizimi I aktiviteteve artistike ,kulturore ,sportive ne shkalle lokale e kombetare.
6. Shitblerjen e te drejtave radiotelevizive tek te tretet dhe nga te tretet.

- 7.Import - eksport ,transport te te gjitha paisjeve ,lendeve te para ,si edhe cdo mjet tjetër ndihmes per mediat audiovizive.
- 8.Import - eksport ,transport, prodhim, riparim e montim per te tretet me matriale te veta ose te porositesit ne fushen audiovizive(Fason).



NENI 4

Shoqerija tregtare "MRM" SHPK fiton personalitet juridik nga dita e regjistrimit te saj ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tirane ne regjistrin tregtar prane kesaj Gjykate.

Ndryshimet e shoqerise duke perfshire edhe percaktime te mevonshme ne lidhje me kohezgjatjen e aktivitetit te shoqerise tregtare nuk sjellin si pasoje krijimin e nje personaliteti juridik te ri.

NENI 5

Shoqerija tregtare "MRM" SHPK do te permbushe objektin e veprimtarise se vet me nje afat te pacaktuar.

NENI 6

Shoqerija tregtare "MRM" SHPK do kete seli qendrore ne teritorin e Rrepublikes se Shqiperise ne qytetin e Korces me adrese : Bulevardi Shen Gjergji ,Hotel Turizmi " Behar Kocibelli "Korce

Shoqerija mund te marre pjese ne krijimin e nje filiali te saj,mund te jete pjesmarse ne nje shoqeri tregtare apo mund te kontrolloje shoqeri te tjerra tregtare si brenda dhe jashte territorit te Rrepublikes se Shqiperise.

Njesite strukturore te shoqerise ne format e mesiperme do te krijohen ne perputhje me legjislacionin shqiptar kur ndodhen brenda territorit te Rrepublikes se Shqiperise dhe jashte saj ne perputhje me legjislacionin e vendit ku personi juridik ka qendren e tij.

NENI 7

Shoqerija tregtare "MRM" SHPK nuk pergjigjet per detyrimet qe rrjedhin nga veprimtaria ekonomike-tregtare apo industriale qe ortaket zhvillojne ne menyre te pavarur prej saj.

NENI 8

Shoqerija tregtare "MRM" SHPK do te filloje veprimtarine e vet tregtare me nje kapital fillestar prej 100 000 Lek.

Pjesmarrja ne kapitalin themeltar te shoqerise tregtare eshte :

1. Z. Renato Kocibelli 40% e kapitalit themeltar.
2. Z. Maksim Sotiri 30% e kapitalit themeltar.
3. Z. Markelian Kuqo 30% e kapitalit themeltar.

Ky kapital ndahet ne pjese te barabarta vlere nominale e te cilave nuk mund te jete me e vogel se 1000 Lek.



NENI 9

Fondet ne para qe vijne nga shlyerja e pjeseve te kapitalit themeltar depozitohen brenda tete ditesh nga grumbullimi I tyre per shoqerine ne formim e siper ne Banken e Kursimeve .

NENI 10

Ne baze te kapitalit themeltar te shoqerise tregtare fitimi do te ndahet ne menyre te percaktuar nga ligja dhe ne Nenin 10 te Aktit te themelimit.

NENI 11

Shoqerija krijon fondin rezerve dhe fondet e tjera te vecanta te financimit per zhvillimin ekonomik ,tregtar,per krijimin e valutes etj.

NENI 12

Shoqerija tregtare "MRM" SHPK eshte pronare e pasurise se saj,te cilen e perdor dhe e disponon ate ne emer te saj ne perputhje me qellimin dhe objektin e veprimtarise se shoqerise.

Shoqerija eshte e lire te bleje dhe te shfrytezoje te drejta te tjera materiale ne perputhje me legjislacionin perkates shqiptar.

Te gjitha shpenzimet per ushtrimin e aktivitetit tregtar,asistence teknike e juridike paguhen nga fondet e shoqerise.

NENI 13

Perberja e kapitalit te shoqerise,fondet e krijimit te saj si dhe perdorimi e rregullimi I cdo fondi te vecante percaktohen nga organi administrativ sipas te drejtave dhe detyrave te percaktuara ne statut.

Te arrdhurat e pergjithshme te shoqerise dhe ne pergjithesi cdo operacion financiar I saj do te pasqyrohen ne kontabilitetin e shoqerise sipas ligjeve ne fuqi dhe ne mbeshtetje te akteve perkatese te rrjedhura prej saj.

Te arrdhurat neto qe do te rezultojne nga bilanci I miratuar nga Asambleja e Ortakeve do te ndahen midis ortakeve te kesaj shoqerije tregtare sipas nenit 10 te Aktit per themelimin e shoqerise.

NENI 14

Pasurite e shoqerise vleresohen ne monedhe shqiptare.

Aktiviteti financiar I shoqerise do te mbyllet me 31 Dhjetor te cdo viti dhe bilanci do te miratohet brenda tre muajve te vitit ne vazhdim.

NENI 15

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimije.Ato jane lirisht te transferueshme edhe ne rast ndarje pasurore midis bashkeshorteve si dhe ndermjet pasardhesve dhe paraardhesve.



NENI 16

Transferimi I pjeseve te kapitalit themeltar me trashegimi ose brenda familjes personave perfitues do te behet pasi ata te pranojne permbajtjen e statutit te kesaj shoqerije tregtare me gjithë ndryshimet qe ai mund te kete pesuar deri ne momentin qe keto pjese te kapitalit themeltar behen te transferueshme.

NENI 17

Ne rast mospranimi pjeset e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri vetem me miratimin e ortakeve ose shihet mundesija e blerjes se tyre nga shoqerija.

NENI 18

Pjeset e kapitalit theemeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve te kesaj shoqerije tregtare.

NENI 19

Zmadhimi I kapitalit themeltar me ane te kontributeve me para dhe ne natyre behet me miratimin e Asamblese se ortakeve mbi bazen e nje projekti te paraqitur nga eksperti kontabel I autorizuar dhe me kerkesen qofte edhe te njerit prej ortakeve themelues.

KREU I DYTE **Ortakeria**

NENI 20

Ortakeria per shoqerine tregtare "MRM" SHPK krijohet dhe mbeshtetet ne aktin e themelimit te kesaj shoqerije dhe ne ligj.

NENI 21

Ortaket e shoqerise tregtare "MRM" SHPK gezojne te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe pasqyrohen ne ligjen tregtare te Republikes se Shqiperise.

KREU I TRETE

NENI 22

Shoqerija tregtare "MRM" SHPK ka si struktura administrative e drejtuese Asamblene e ortakeve dhe Administratorin.

Shoqerija tregtare me miratim te asamblese se ortakeve vendos dhe emertime honorifike te anetareve te saj.

Per realizimin e veprimtarise televizive "LOBI VIZION" Asambleja e ortakeve emeron strukturat ne mbeshtetje te ligjit Nr 8410 dt.30.9.1998 "Per radion dhe televizionin publik e privat ne Republiken e Shqiperise".



NENI 23

Asambleja e ortakeve eshte organi me I larte vendimor I shoqerise tregtare

“MRM” SHPK.

Ne perberje te kesaj asambleje perfshihet ortaket themelues te kesaj shoqerije.

Asambleja e ortakeve ka te drejte:

- te miratoje bilancin vjetor te shoqerise.
- te hartoje e miratoje ndryshimet ne statut.
- te vendose per rritjen apo zvogelimin e pjeseve te kapitalit themeltar te shoqerise tregtare.
- te emeroje dhe shkarkoje Administratorin e shoqerise tregtare.
- te shpalle prishjen,likujdimin dhe falimentimin e shoqerise tregtare.
- te shprehet per kohezgjatjen e shoqerise tregtare.
- te miratoje mareveshjet e arritura ne qarkullimin civil te saj.
- te miratoje strukturat e shoqerise
- te emeroje dhe shkarkoje personat ne perberje te strukturave te saj.
- te percaktoje regulloren e funksionimit te strukturave.
- te hartoje strategjite perkatese per cdo aktivitet publik te shoqerise.

NENI 24

Asambleja e ortakeve e shoqerise tregtare “MRM” SHPK thirret te pakten nje here ne vit.

Ortaku lajmerohet me leter rekomande ose me telegram me lajmerim marrje te pakten 15 dite para mbledhjes se Asamblese.Ne kete lajmerim njoftohet rendi I dites.

Lajmerimi behet nga Administratori.

Mospjesmarja e ortakut te lajmeruar duhet te pasohet me njoftimin urgjent te shkaqeve te mosparaqitjes dhe njoftimin e administratorit per daten e mundshme te paraqitjes.Me kete rast duhet te respektohet afati I percaktuar ne paragrafin e dyte te ketij Neni.

Mosparaqitja e ortakut te thirrur pa shkaqe te aresyeshme perben shkelje te detyrave te ortakut te percaktuar ne Aktin e themelimit.

Cdo klauzole e kundert eshte e pa vlefshme ne kete rast.

NENI 25

Ortaku ne kete shoqeri tregtare nuk mund te ngarkoje nje mandatmbajtes te votoje ne emer te nje pjese te kapitalit te tij themeltar duke votuar ai vete ne emer te pjeses tjeter te kapitalit te tij themeltar.

NENI 26

Administrimi I shoqerise tregtare “MRM” SHPK kryhet nga personi fizik I zgjedhur ne cdo rast nga ortaket themelues te shoqerise tregtare.

Ai emerohet me vendim te asamblese se ortakeve.

Administratore te shoqerise tregtare jane emeruar z.Maksim Sotiri dhe Renato Kocibelli.

Detyrat e administratorit jane:

- REPUBLICA E SHQIPËS
KRYEMINISTRI
- te mbikqyre dhe kontrolloje gjithë veprimtarine e shoqerise.
 - te vendose per cdo problem qe I lind shoqerise ne periudhen midis dy mbledhjeve te Asamblese ne zbatim te detyrave te saj.
 - te perfaqesoje shoqerine tregtare ne maredheniet e saj me te tretet dhe ne konfliktet gjyqsore.
 - te emeroje prane shoqerise personelin e domosdoshem qe I nevojitet asaj ne permbushjen e aktivitetit tregtar e ekonomik.
 - te paraqese per miratim Asamblese se ortakeve strukturen e brendeshme organizative te shoqerise tregtare me emra perkates dhe te permbushe gjithë detyrimet ligjore qe rrjedhin nga Kodi I Punes I Republikes se Shqiperise.
 - te testoje aftesine e punonjesve ne administrate.
 - te mbledhe Asamblene e ortakeve dhe te propozoje ceshtjet qe duhen analizuar.
 - te hartoje objektivat e shoqerise tregtare per cdo vit pasues dhe te vendose e te ndjeke realizimin e detyrave te lena nga asambleja e ortakeve etj.
 - Te informoje me shkrim ortaket per cdo problem qe I kerkohet.
 - Te mare pjese ne mbledhjet e strukturave te veprimtarise televizive dhe te cdo strukture organizative ne permbushje te objektit te kesaj shoqerije tregtare.

NENI 27

Administratori eshte pergjegjes individualisht sipas rastit ndaj vete shoqerise ose ndaj te treteve per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

NENI 28

Shoqerija tregtare "MRM" SHPK emerone eksperte kontabel te autorizuar. Emerimi kryhet nga Asambleja e ortakeve. Per kopetencat, detyrimet, pergjegjesite, zevendeshmerine, terheqjen, shkarkimin dhe shperblimi I ekspertit kontabel te autorizuar zbatohet legjislacioni shqiptar ne fuqi.

NENI 29


Ortaket themelues kane rene dakort qe te gjithë personat qe do te punesohen prane kesaj shoqerije tregtare, punesimi I tyre do te behet mbi bazen e nje kontrate te vecante ne te cilen do te percaktohen te drejtat dhe detrimet ligjore te sejciles pale si dhe paga mujore ne mbeshtetje te legjislacionit shqiptar ne kete fushe

KREU I KATERT

Bashkimi dhe ndarja e shoqerise.

NENI 30

Shoqerija tregtare "MRM" SHPK me ane te bashkimit mund ti kaloje trashegimine e saj nje shoqerije egzistuese ose nje shoqerije te re qe ato themelojne


Shoqerija tregtare "MRM" SHPK gjithashtu me ane te ndarjes mund ti kaloje trashegimin e saj disa shoqerive te tjera egzistuese ose disa shoqerive te reja.

NENI 31

Ne rast se operacioni perfshin krijimin e shoqerive te reja sejcila prej tyre themelohet sipas regullave qe I perkasin formes se shoqerise qe do te krijohet.

KREU I PESTE **Likujdimi I shoqerise.**

NENI 32

Likujdimi I shoqerise tregtare "MRM" SHPK vendoset nga Asambleja e ortakeve kur:

1. me plotesimin e qellimit te krijimit te kesaj shoqerije tregtare.
2. kur eshte vendosur bashkimi apo ndarja e shoqerise.
3. kur priset shoqerija.

NENI 33

Ne kete rast nga ana e asamblese se ortakeve caktohet nje likujdues te cilit I ngarkohet ne menyre te specifikuar detyra mbi menyren e likujdimit.

Ne rastin e parashikuar ne Nenin 37 pika "3" likujdimi vendoset nga Gjykata me kerkesen e administratorit. Kerkesa duhet te permbaje dokumentacionin e parashikuar ne kete Statut.

NENI 34

Transferimi I plote I aktivitet te shoqerise apo kontributi ne aktiv te nje shoqerije tjeter, vecanerisht me ane te procesit te bashkimit duhet te autorizohet me pelqimin e Ortakeve themelues.

NENI 35


Ortaket thiren ne fund te procesit te likujdimit qe te vendosin per bilancin financiar perfundimtar.

NENI 36

Neqoftese mbledhja e Asamblese per mbylljen e parashikuar ne nenin 35 nuk mund te marre vendim ose neqoftese ajo nuk pranon te miratoje llogarite e Likujduesit vendimi meret nga Gjykata me kerkesen e Likujduesit ose te cdo personi te interesuar.

Procedura qe duhet te ndjehet Gjykata ne kete rast percaktohet nga Asambleja e ortakeve dhe duhet te gjeje pasqyrimin e vet ne statut ne nje kohe te mevoneshme qe nga krijimi I shoqerise ,por ne cdo rast jo me vone se 6 muaj nga krijimi I saj.

Ne rast se nuk eshte proceduar si me siper Gjykata me miratimin e Asamblese se Ortakeve te shoqerise tregtare zbaton dispozitat ligjore. Ne rast se miratimi nuk eshte dhene deri ne seancen e pare gjyqesore ky prezurmohet I mireqene.





NENI 37

Prishja e shoqerise tregtare.

Shoqerija tregtare "MRM" SHPK priset kur:

1. Ortaket themelues nuk respektojne te drejtat dhe detyrimet e percaktuara ne Aktin e themelimit dhe ne kete statut.
2. veprimtaria e ortakut te shoqerise perben shkelje te renda te Aktit te themelimit dhe te statutit.
3. Kur ortakut themelues refuzon pjesmarrjen ne mbledhjet e Asamblese se ortakeve pas dy lajmerimeve radhazi dhe cmohet pamundesia e permbushjes se objektit te shoqerise.
4. Shoqerija nuk priset kur vdes nje prej ortakeve.
5. Shoqerija nuk priset kur falimenton ose shfaq paaftesi nje prej ortakeve.

NENI 38

Te gjitha mosmareveshjet midis ortakeve, pjesmares ne kete shoqeri tregtare zgjidhet me mirekuptim nga ana e tyre.

Ne rastet kur mosmareveshjet nuk mund te zgjidhen ne rruge administrative sejcili prej ortakeve ka te drejte ti drejtohet per zgjidhje Gjykates se Rrethit Gjyqesor Korce.

NENI 39

Ky statut perpilohet ne 6(gjashte) egzemplare origjinale dhe pasi u lexua dhe u studiuua nga ortaket themelues nenshkruhet prej tyre,

NESHKRIMI

Renato KOCIBELLI

Maksim SOTIRI

Markeljan KUQO

REPUBLICA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE KORCE
NOTERI VLADIMIR MOLLA.
NR 2179 Rep.
NR 415 Kol.

VERTETIM NENSHKRIMI

Sot, me 2.05.2001, ditën e Merkurë, pra meje Noter VLADIMIR FEHMI MOLLA, anetar i Dhomes se Notereve Korce, qe kryej veperimtari si Noter ne zyren qe ndodhet ne Qytetin e Korces ne Rrugen "6 Deshmoret", u paraqiten qytetaret ~~Boneto KOCIRI~~ BIRI I Beharit dhe I Krisanthit, me dt. lindje 1963, banues ne Korce, ~~M. si~~ I biri I Vangjelit dhe I Julia, me dt. lindje 1962, banues ne Korce, ~~Markellan KUQO~~ I biri I Gezimit dhe I Zhanetes, me dt. lindje 1972, banues ne Korce, madhore, te afte per te kryer veprime juridike, te njohur prej meje Noterit, te cilet nenshkruan ketu para meje Statutin e Shoqerise tregtare "MRM" Shpk, me qender ne Korce, si ortake themelues te kesaj shoqerije dhe une Noteri sipas ligjit vertetoj nenshkrimin e tyre.

NOTER
VLADIMIR FEHMI MOLLA

